



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 186, Datë 06.07.2026

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË
“YILDIRIM ENERGY EUROPE ALBANIA” SH.P.K. PËR RINOVIMIN E LICENCËS
NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, 5, pika 1, gërma “d”, 10, pikat 1 dhe 3, si dhe 16 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.07.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/1 prot., datë 03.07.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021, me afat vlefshmërie deri më 21.12.2026.
- Nga verifikimi paraprak i aplikimit rezulton se në momentin e licencimit shoqëria ka qenë identifikuar me emrin “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., emër të cilin e ka ndryshuar në vijim, në datën 28.09.2022, në “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., gjë që është reflektuar dhe në rishikimin e vendimit në kuadër të plotësimit të kushteve.
- Shoqëria ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1923 prot., datë 22.06.2026.
- Në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, përcaktohet se paraqitja e kërkesës për rinovimin e licencës bëhet jo më vonë se 6 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë (data e përfundimit të licencës nr. 496, Seria F21, është 21.12.2026) dhe si e tillë aplikimi duhet të kryhej në datën 21.06.2026.
- Në nenin 56, pika 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se në rast se dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ndaj, duke qenë se afati i fundit (data 21.06.2026) ka qënë ditë e dielë, paraqitja e aplikimit në datën 22.06.2026, konsiderohet

në afat sipas përcaktimeve të KPA-së. Nga sa konstatohet, shoqëria e ka paraqitur aplikimin e saj brenda afatit të parashikuar në nenin 16, pika 1 të Rregullores.

- Rezulton se kërkesa për rinovim, shtojcat dhe deklaratat janë nënshkruar vetëm nga një prej administratorëve të shoqërisë. Referuar ekstraktit historik, shoqëria ka dy administratorë që e përfaqësojnë atë vetëm bashkërisht, me nënshkrim të përbashkët. Sa rakorduar, rezulton se pagesa e aplikimit është bërë nga llogaria bankare e shoqërisë, si e tillë vlerësohet se ka një vullnet të shoqërisë për paraqitjen e aplikimit për rinovim. Gjithsesi, vlerësohet që t'i sqarohet shoqërisë se aktet duhet të depozitohen të nënshkruara sipas kompetencave të administratorëve të përcaktuara në ekstraktin e regjistrit tregtar të QKB-së.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”* e ndryshuar, si dhe ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit si dhe shoqëria ka paraqitur dokumentacionin bazë të kërkuar për fillimin e procedurës administrative.
- Për sa depozituar nga shoqëria dhe në referencë të përcaktimeve të Rregullores, vlerësohet se aplikimi duhet të plotësohet me dokumentacionin dhe sqarime të mëtejshme, në përputhje me kërkesat e Rregullores së Licencimit, përpara se Bordi të shprehet përfundimisht mbi kërkesën. Në vijim aplikimi duhet të plotësohet dhe me dokumentacionin si vijon:
 - *dëshmia e penaltetit për vetë shoqërinë dhe për administratorët e saj;*
 - *vërtetimi i përditësuar në lidhje me shlyerjen e detyrimeve ndaj sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;*
 - *plani i biznesit;*
 - *dokumentimi i disponimit të mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë;*
 - *informacion në lidhje me sistemin e IT për ushtrimin e aktivitetit të furnizimit;*
 - *sqarime në lidhje me afatin e kontratës së qirasë së zyrave përfaqësuese të furnizimit.*

Nga analiza paraprake nuk rezultojnë rrethana që të pengojnë fillimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës, ndërsa vlerësimi mbi përmbushjen e të gjitha kushteve ligjore dhe rregullatore për licencim do të kryhet në përfundim të procedurës administrative, pas administrimit të dokumentacionit të plotë dhe analizës nga ERE. Nga shqyrtimi paraprak rezulton se aplikimi është paraqitur në formatin e kërkuar nga Rregullorja e Licencimit dhe është shoqëruar me dokumentacionin bazë të nevojshëm për fillimin e procedurës administrative.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për rinovimin e licencës nr. 496, Seria F21, të shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 258, datë 21.12.2021.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI